



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 51, Datë 07.03.2018

MBI

**MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “POWER ELEKTRIK SLABINJE”
SH.P.K., PËR LËNIEN PENG TË ASETVE TË SAJ PRANË “RAIFFEISEN BANK”
SH.A.**

Në mbështetje të nenit 16; nenit 20 pika “a”, nenit 44, pika 1 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; në zbatim të nenit 7 dhe 11 të “Rregullores për procedurat e transferimit të asetve nga të licencuarit”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.07.2016; pikës 1.3 dhe 1.6 të “Licencës për Prodhimin e Energjisë Elektrike”, miratuar me Vendimin Nr. 99, Datë 17.06.2016 si dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i E.R.E-s, në mbledhjen e tij të datës 07.03.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi kërkesën e shoqërisë “Power Elektrik Slabinje” sh.p.k, për lënien peng të asetve në favor të “Raiffeisen Bank” sh.a,

-

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me Vendimin nr.151, datë 28.09.2017 ka vendosur : Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Power Elektrike Slabinje” sh.p.k për lënien peng të asetve, për garantimin e detyrimeve të kredisë që kjo shoqëri ka ndaj Raiffeisen Bank sh.a.
- ERE nëpërmjet shkresës me nr.233/3 prot, datë 05.10.2017, ka njoftuar shoqërinë “Power Elektrik Slabinje” sh.p.k. për plotësimin e dokumentacionit të munguar, të konstatuar në Vendimin nr.151, datë 28.09.2017.
- Shoqëria “Power Elektrik Slabinje” shp.k. me shkresën nr.180 prot, datë 31.10.2017, ka plotësuar pjesërisht dokumentacionin e munguar.
- Shoqëria “Power Elektrik Slabinje” sh.p.k., me shkresën nr.186 prot, datë 24.12.2017, kërkoi nga ERE shtyrjen e afatit të mbledhjes së bordit deri në miratimin nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të transferimit të asetve në favor të “Raiffeisen Bank”sh.a.

- Shoqëria “Power Elektrik Slabinje” sh.p.k me shkresën me nr. 192 prot, datë 22.02.2018, ka përcjellë në ERE shkresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.45/3prot, datë 20.02.2018, ku miratohet transferimi i aksioneve ose asetëve pjesë të kapitalit.

Aplikimi plotëson tërësisht kërkesat e parashikura nga ERE në “Rregulloren për Procedurat e Transferimit të Asetëve nga të Licencuarit” si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 gërmat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, “j”, “k”, janë plotësuar në mënyrë korrekte.
- Neni 7 pika 3 është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Power Elektrik Slabinje” sh.p.k. për lënien peng të asetëve në favor të “Raiffeisen Bank” sh.a. (lista bashkëlidhur).
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI

Lista e aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të lëna peng në favor të “Raffaisen Bank” sh.a., nga shoqëria “Power Elektrik Slabinje” sh.p.k

1. Turbinat e ujit dhe pajisjet e shpërndarjes dhe instalimit copë 10,
2. Sistemi i kontrollit dhe pjesët përbërëse copë 4,
3. Sistemi i komandimit, 3 njësi me pjesët përbërëse copë 2,
4. Paneli i frenimit, 3 njësi me pjesët përbërëse copë 1,
5. Pajisje e impulsit KL-46, 3 njësi me pjesët përbërëse copë 3,
6. Valvul 700KD41H-25VK, copë 1,
7. Komutator i tensionit të lartë, 6 njësi me pjesët përbërëse copë, 5,
8. Valvul 900KD41H-25VK, 2 njësi me pjesët përbërëse, copë 2
9. Kabell i tensionit të lartë 900m, copë 3,
10. Kabëll i tensioit të ulët 18620m, copë 9,
11. Gjenerator SFW4300-8/2150, 1 njësi me pjesët përbërëse copë 8,
12. Gjenerator SFW2400-6/1430, 2 1 njësi me pjesët përbërëse copë 5,
13. Transformator S9-160, 3 njësi me pjesët përbërëse, copë 1,
14. Transformator S6300-121, 2 njësi me pjesët përbërëse copë 9,
15. Transformator s3200-110, 1 njësi me pjesët përbërëse copë 10,
16. Turbinat e ujit dhe pajisjet shpërndarjes dhe instalimit copë 11,
17. Pajisje 100KV, 1 njësi me pjesët përbërëse copë 5,
18. Vinc, 1 njësi me pjesët përbërëse copë 12,
19. Fiber optik 24200 M dhe pjesët përbërëse, copë 12.